



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 66 Akti

Nr. 88 Vendimi

Tiranë, më 17.12.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland	ILIA	Kryesues
Etleda	ÇIFTJA	Anëtare
Firdes	SHULI	Relatore

me sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, më datë 13.12.2018, ora 13:00 dhe datë 17.12.2018, ora 09:30, pranë Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati i 2-të, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arben Kraja**, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithëshme.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatimin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Kraja, proces i cili ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tre kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Arben Kraja është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si “ligji nr. 84/2016”), të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Kraja, ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme që nga viti 1993. Si i tillë, në bazë të nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar në shortin e datës 15.01.2018.

3. Me shkresën nr. ***, datë 13.11.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 13.11.2017 (17 fletë), Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (më poshtë referuar si “ILDKPKI”) ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja (32 fletë), si dhe 1 (një) dosje me nr. IND ***.

4. Me shkresën nr. ***, datë 31.10.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me nr. *** prot., datë 15.11.2017, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, (më poshtë referuar si “DSIK”), ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja (12 fletë).

5. Me shkresën nr. *** prot., datë 11.04.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me nr. *** prot., datë 18.04.2018, Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme,

ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja (34 fletë).

6. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (me poshtë referuar si “Komisioni”), ka zhvilluar shortin, më datë 15.01.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Kraja, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Eteda Çiftja, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

7. Me fillimin e procesit të rivlerësimit, trupi gjykues administroi:

7.1 Aktin për vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga ILDKPKI-ja.

7.2 Raportin e vlerësimit të figurës, sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga DSIK-ja.

7.3 Raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

8. Me vendimin nr. 1, datë 24.01.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Arben Kraja, duke përfshirë të tre kriteret, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin z. Roland Ilia. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Me vendimin nr. 2, datë 03.12.2018, trupi gjykues vendosi:

9.1 Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me verifikimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja.

9.2 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar atij barrën e provës mbi rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, për të paraqitur prova e shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

9.3 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

9.4 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për t’u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar konflikt interesi.

10. Më datë 07.12.2018, subjekti në rrugë elektronike, vuri në dispozicion të Komisionit parashtrësë me pretendimet e tij dhe dokumente shkresore bashkëngjitur.

11. Me vendimin nr. 3, datë 11.12.2018, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Arben Kraja, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë

13.12.2018, ora 13:00 paradite, pranë Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati i 2-të, Tiranë.

12. Më datë 13.12.2018, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Kraja, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Kraja, bazuar në të tre komponentët: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1. VLERËSIMI I PASURISË

II.1.a Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private nga viti 2004 (për vitin 2003) deri në vitin 2017 (për vitin 2016). Më datë 20.01.2017, sipas ligjit nr. 84/2016, subjekti ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar Vetting” pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me aktin nr. ***, datë 13.11.2017, ka konkluduar se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

II.1.b. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues

^[1] “41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund

realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, si dhe komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në:

- a) Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur;
- b) Verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë;
- c) Evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive;
- ç) Evidentimin e deklaratimeve të rreme;
- d) Nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit,

me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ nga ana e Komisionit, sipas neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me pasuritë si vijojnë:

1. Shtëpi banimi, me sipërfaqe 117 m², mbi truallin 542 m², ndodhur në, Rr. “**”, nr. ****, Shkodër, të cilën e zotëron 100 % nga viti 1995, regjistruar me nr. ****, në ZK ****, vol ****, faqe ****, ZVRPP-së Shkodër. Burimi i deklaruar i krijimit të pasurisë, trashëgimi nga prindërit, të cilët e kanë blerë në vitin 1956. Pasuri e parivlerësuar.**

1.1.Nga hetimi administrativ rezultoi se :

1.1.a. ZVRPP-ja Shkodër¹, konfirmon se, z. Arben I. Kraja, është pronar në pasurinë nr. ****, truall me sipërfaqe 542 m², nga kjo 117 m² ndërtesë, vol ****, fq. ****, ZK. ****.

të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “*procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë*”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “*në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.*”

¹ Shih shkresën, nr. ****prot., datë 15.10.2018, të ZVRPP-së Shkodër në dosjen e Komisionit.

1.1.b. OSHEE konfirmon se² për këtë pasuri nuk ka kontratë të energjisë elektrike.

1.2 Kjo pasuri është deklaruar :

1.2.a. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2003, si pasuria me nr. ***, regjistruar në hipotekë me nr. *** prot., datë 07.09.2000, fituar me trashëgimi.

1.2.b. Në deklaratën “Vetting”, si pasuria me numër ***, me përshkrimin si në pikën 1 më sipër.

Nuk kanë rezultuar pasaktësi ne deklarime.

1.3 Lidhur me origjinën e pasurisë :

Për tu qartësuar lidhur me origjinën e kësaj pasurie si pasuri e ardhur nga trashëgimia (sipas deklaratimit të subjektit), iu kërkua informacion i detajuar ZVRPP-së Shkodër si dhe u pyet subjekti i rivlerësimit.

Nga provat e vëna në dispozicion nga ZVRPP-ja Shkodër³ si dhe nga shpjegimet dhe dokumentet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit⁴, lidhur me origjinën e kësaj pasurie dhe mënyrën e regjistrimit të saj pranë ZVRPP-së Shkodër, si pasuria me nr. ***, u administruan:

1.3.a. Akt shitblerje, më datë 18.09.1956, i pasurisë, në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë, blerë nga prindërit e subjektit, I. e H. K dhe i quajturi E. I. K.

1.3.b. Vërtetim pronësie, datë 25.05.1993, në emër të shtetases H. K, lëshuar nga Zyra e Hipotekës Shkodër, për pjesën e saj takuese në këtë pasuri.

1.3.c. Vërtetim pronësie, datë 25.05.1993, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja, lëshuar nga Zyra e Hipotekës Shkodër, për pjesën e tij takuese në këtë pasuri.

1.3.d. Kontratë dhurimi, datë 10.09.1993, me të cilën znj. H. K i ka dhuruar pjesën e saj subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja.

1.3.e. Deklaratë personale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.06.2000, e z. Arben Kraja, për disponimin nga ana e tij të të gjithë pasurisë dhe deklaratë noteriale e pronarëve kufitarë, nr.

² Shih, vërtetimin nr. *** prot., datë 06.11.2018, të OSHEE-së në dosjen e Komisionit dhe shkresën nr. ***prot., datë 15.11.2018, në dokumentet bashkëngjitur me përgjigjet e pyetësorit të kthyer, më datë 15.11.2018, në dosjen e Komisionit.

³ Shih, shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2018, të ZVRPP-së Shkodër në dosjen e Komisionit dhe nr. *** prot., datë 27.11.2018.

⁴ Shih, përgjigjet e datës 17.10.2018 të pyetësorit nr. 2, pika 1, në dosjen e Komisionit, si dhe dokumentet, në dosjen e Komisionit.

Shih, përgjigjet për pyetësorin e datës 12.11.2018 të dërguara, më datë 16.11.2018, në dosjen e Komisionit si dhe dokumentet bashkëngjitur.

*** rep., nr. *** kol., datë 24.06.2000, me të cilën kufitarët konfirmojnë kufizimin e pasurive të tyre me këtë pasuri, si dhe faktin se nuk kanë pasur konflikte pronësie mes tyre. Mbi bazën e akteve të sipërpërmendura dhe këtyre deklaratave, është bërë regjistrimi i pasurisë numër *** në emër të subjektit, sipas ligjit 7843, datë 13.07.1994, neni 24 germa “b”.

1.3.f. Katër fletë nga regjistri hipotekor, ku janë përmendur përveç akteve si më sipër dhe disa vendime gjyqësore që kanë shërbyer si bazë për regjistrimin e pasurisë.

1.3.g. Vërtetim nga Hipoteka Shkodër me nr. *** prot., datë 16.11.2018, me të cilat vërtetohet se:

- fleta e regjistrimit nr. ***, datë 01.07.1970, e cila përbën origjinën e pasurisë nuk ndodhet pranë ZVRPP-së Shkodër.

- pasuria rezulton të jetë pjesëtuar mes palëve Arben e H. K, e regjistruar në radhorin e pronësisë nr. *** dhe nr. ***, datë 25.05.1993, në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. ***, datë 16.10.1992, i cili nuk administrohet pranë ZVRPP-së Shkodër.

1.3.i. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me të cilën konfirmohet se nuk rezulton të ketë vendim ***, datë 16.10.1992, për shkak se dokumentacioni i ndodhur në këtë arkiv, është dëmtuar nga djegia në trazirat e viteve 1997 dhe 1998.

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në të gjitha provat e grumbulluara sa më sipër, në sqarimet e subjektit, si dhe, pasi u vërtetua pamundësia objektive për të administruar një dokument që vërteton trashëgiminë si burim krijimi i pasurisë, trupi gjykues krijoi bindjen se në origjinën e saj, kjo pasuri ka qenë pasuri prindërore, dhe është fituar në mënyrë të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit.

1.4 Për një hetim sa më të thellë administrativ, lidhur me investimin për këtë pasuri:

1.4.a. U pyet subjekti i rivlerësimit për gjendjen aktuale të pronës, si dhe nëse ka kryer shpenzime për investime, i cili ka shpjeguar se nuk ka kryer investime në këtë pasuri që nga momenti i fitimit të pronësisë (1995)⁵.

1.4.b. U kërkua në *google map*, sipas adresës së deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, Rr. “***”, Shkodër, banesa nr. ***. Pas kërkimit, rezultoi se në këtë adresë, ndodhej edhe një ndërtesë 3-katëshe, e cila faktikisht nuk rezultoi të kishte një numër⁶.

1.4.c. Për të verifikuar dhe hequr çdo dyshim, lidhur me faktin se ajo mund të ishte banesa që subjekti ka deklaruar, i është kërkuar informacion Drejtorisë së ALUIZNI-t lidhur me gjendjen aktuale të pasurisë nr. ***, si dhe nëse kjo pasuri është pikërisht banesa 3-katëshe e marrë nga *google map*, pamja e të cilës i është vënë në dispozicion këtij institucioni.

⁵ Shih, përgjigjet e datës 17.10.2018 të pyetësorit nr. 2, pika 1, në dosjen e Komisionit dhe përgjigjet për pyetësorin e datës 12.11.2018 të dërguara, më datë 16.11.2018, në dosjen e Komisionit si dhe dokumentet bashkëngjitur.

⁶ Shih, fotot e nxjerra nga *google map* në dosjen e Komisionit.

Në përgjigjen e dhënë⁷, nuk rezulton të bëhet fjalë për të njëjtën pasuri. Gjithashtu është vënë në dispozicion fragment nga *ortofoto* (fotografimi ajror) si dhe CD, ku pasqyrohet vendndodhja e pasurisë. Nga këto materiale, rezulton që pasuria, nr. ***, është një banesë e vjetër një katëshe, me çati me rasa guri të kuqe, ashtu sikurse rezulton të jetë në fotot që subjekti ka vënë në dispozicion për Komisionin.

1.4.d. Iu kërkua informacion OSHHE-së e cila konfirmon se⁸, për këtë pasuri nuk ka kontratë të energjisë elektrike.

Bazuar në faktet sa ma sipër, Komisioni krijoi bindjen se subjekti nuk ka kryer investime në këtë banesë.

2. Apartament banimi, me sipërfaqe 138 m², ndodhur në Njësinë Administrative Nr. *, Rr. “***”, ndërtesa ***, hyrja ***, apartamenti ***, Tiranë.** Pronësia është fituar sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 09.04.2004, me “****” sh.p.k., në shumën 56.571 euro, në bashkëpronësi (50 %) me bashkëshorten, banuar nga shtatori 2005, e pa hipotekuar.

Burimi i deklaruar i krijimit të pasurisë :

- të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm, ndodhur në, Rr. “****”, Tiranë, në vitin 2005;
- kredi në banka;
- kursime nga të ardhurat familjare ndër vite.

2.1 Nga hetimi administrativ rezultoi se:

2.1.a. ZVRPP-ja Tiranë konfirmon⁹ se, në emër të z. Arben I. Kraja dhe znj. G. K nuk figurojnë pasuri të regjistruara. (Kjo për shkak se nuk ka kaluar pronësia me akt noterial).

2.1.b. OSHEE-ja konfirmon se,¹⁰ referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me gjeneralitetet Arben I. Kraja, me kontratë nr. ***, Tiranë, (që i përket pasurisë objekt shqyrtimi), ndërsa për sa i përket kontratave me kod ***, *** dhe me kod ***, me gjeneralitetet Arben Kraja, ato nuk i përkasin subjektit të rivlerësimit.

2.2. Kjo pasuri është deklaruar:

2.2.a. Në deklaratën për vitin 2004 me përshkrim “Prenotim apartamenti sipas kontratës së sipërmarrjes me firmën “****” sh.p.k., me sip. 138 m², e pa hipotekuar, paguar kësti i parë në

⁷ Shih, shkresën nr. ***prot., datë 27.11.2018, të ALUIZNI-t, në dosjen e Komisionit.

⁸ Shih, vërtetimin nr. ***prot., datë 06.11.2018, të OSHEE-së në dosjen e Komisionit dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2018, në dokumentet bashkëngjitur me përgjigjet e pyetësorit të kthyer, më datë 15.11.2018, në dosjen e Komisionit.

⁹ Shih, shkresën nr. *** prot., datë 12.02.2018, së bashku me dokumentacionin shoqërues në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Shih, shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2018, në dosjen e Komisionit.

vlerën 45.000 euro sipas kontratës kredisë me “NBG”-në. Pjesët takuese: 50 %. Në po këtë deklaratë në kolonën detyrime financiare, është deklaruar marrja e kredisë për blerje banese në vlerën 45.000 euro për 17 vjet, me 6.5 %, sipas kontratës, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.05.2004.

2.2.b. Në deklaratën “Vetting”, është deklaruar si në pikën 2 më sipër.

2.3 Nga deklarinimet periodike për këtë pasuri, ka rezultuar se:

2.3.a Ka një mospërputhje të çmimit të shitjes në kontratën e sipërmarrjes në të cilën ky çmim është shënuar në vlerën 60.000 euro, me deklarinimet periodike, duke përfshirë dhe deklaratën “Vetting”, ku çmimi i shitjes është deklaruar në vlerën 56.571 euro.

Nga dokumentet e administruara nga ILDKPKI-ja¹¹, rezultoi se subjekti ka vënë në dispozicion, përveç kontratës së sipërmarrjes me çmim në vlerën 60.000 euro, dhe një kontratë përfundimtare shitjeje pa datë dhe të panoterizuar, të depozituar në zyrën noteriale të noterit R.K., me çmim shitje të parashikuar si përfundimtar në vlerën prej 56.761 euro. Kjo kontratë është lidhur dhe nënshkruar prej palëve, në pritje të procedurave të regjistrimit të pallatit në hipotekë.

Nisur nga këto dy akte dhe bazuar në shpjegimet e subjektit¹², Komisioni çmoi se shkak i mospërputhjes së çmimit të kontratës së sipërmarrjes me çmimin e deklaruar nga subjekti, kanë qenë pikërisht dy marrëveshjet paraprake për blerjen e pasurisë, të përmendura më sipër: Njëra kontrata e sipërmarrjes, më datë 09.04.2004, për shumën 60.000 euro dhe tjetra kontrata e panoterizuar e shitjes (pa datë), për shumën 56.761 euro. Ndërkohë, merret në konsideratë fakti se nuk është bërë kalimi përfundimtar i pronësisë në emër të subjektit.

2.3.b Në deklarinimin për vitin 2005, është deklaruar si këst i dytë për blerjen e kësaj pasurie, shuma prej 11.571 eurosh. (Kësti i parë ka qenë në shumën prej 45.000 euro të paguara me marrjen e kredisë nga “NBG”-ja, më datë 30.04.2004). Ndërkohë, u vërtetua me deklarinimet e subjektit si dhe konfirmimin nga “ABI Bank” (ish-NBG) ,¹³ se kësti i dytë i paguar realisht, është në vlerën 14.750 euro, shumë e kaluar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., më datë 31.12.2005, menjëherë sa është lëvruar kredia në shumën 15.000 euro.

Pra, rezulton që në këstin e dytë është paguar shuma rreth 3.000 euro më shumë nga sa ka deklaruar subjekti, duke u paguar në total shuma prej 60.000 eurosh, në përputhje me kontratën e sipërmarrjes, datë 09.04.2004. Deklarimi i këstit në shumën prej 11.571 euro, është bërë nga ana e subjektit, për të qenë korrekt me çmimin e parashikuar në kontratën e shitjes përfundimtare të panoterizuar. (56.761 euro).

¹¹ Shih, kontratat bashkëngjitur fletës nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Shih, përgjigjet e datës 17.10.2018 të pyetësorit nr. 2, pika 2.1, në dosjen e Komisionit.

¹³ Shih, shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2018, në dosjen e Komisionit.

2.4. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie:

2.4.a. Të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm, ndodhur në, Rr. “****”, Tiranë, në vitin 2005.

Nga aktet rezulton se subjekti ka pasur në pronësi një apartament 2+1, me sip. 82.3 m², ndodhur në, Rr. “****”, të cilin ia ka shitur shtetasit Z. M. L, si pasuria me nr. ***, në shumën 2.5 milion lekë.¹⁴

Deklarimi për vitin 2003 ka qenë korrekt, pasi kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit sipas ligjit, si pasuri e përfituar me kredi nga Banka e Kursimeve, në shumën 2.500.000 lekë.

Gjatë hetimit administrativ ka pasur paqartësi lidhur me kredinë prej 2.500.000 lekë të marrë nga Banka e Kursimeve, pasi, ndërkohë që kjo kredi është deklaruar si e përdorur për blerjen e apartamentit në, Rr. “****”, nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti ka blerë një apartament tjetër në, Rr. “****”, në vitin 2000, me kredi në po këtë shumë, pra në shumën 2.500.000 lekë, nga Banka e Kursimeve¹⁵ (i shitur tek ish-shitësit në vitin 2001).

Për t’u qartësuar lidhur me faktin se për blerjen e cilës pasuri është përdorur kredia prej 2.500.000 lekësh, për blerjen e apartamentit të ndodhur në, Rr. “****”, apo në apartamentit e ndodhur në, Rr. “****”, i janë kërkuar sqarime subjektit të rivlerësimit dhe “Raiffeisen Bank”.

Subjekti ka sqaruar hollësisht dhe ka vërtetuar¹⁶ procedurat e marrjes së kredisë prej 2.500.000 lekësh, në vitin 1994, të cilën e ka përdorur për blerje apartamenti në, Rr. “****”, përfituar si i pastrehë, sipas VKM-së, nr. 605, datë 05.12.1994, nga Enti Kombëtar i Banësive, dhe për përmirësim kushtesh banimi/zgjerimi, sipas VKM-së, nr. 102, datë 05.03.1999 (e deklaruar dhe në deklaratën “Vetting”).

Gjithashtu, për një hetim të thelluar administrativ, u kërkuar informacion “Raiffeisen Bank”. (ish Banka e Kursimeve), e cila ka dhënë kredinë në shumën prej 2.500.000 lekësh, e cila ka vënë në dispozicion informacion të detajuar, bazuar në dokumente ligjore¹⁷.

Nga të gjitha provat e administruara nga Komisioni, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi në, Rr. “****”, rezultoi e vërtetuar se:

¹⁴ Shih, kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.01.2005, bashkëngjitur me shkresën, nr. *** prot., datë 12.02.2018 të ZVRRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Shih, kontratën e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2000, me të cilën është blerë nga çifti K., pasuria me nr. ***, bashkëngjitur me shkresën nr. *** prot., datë 12.02.2018 të ZVRRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Shih përgjigjet e datës 17.10.2018 të pyetësorit nr. 2, pika 2.4 - 2.4.f, në dosjen e Komisionit, si dhe dokumentet bashkëngjitur. Kontratë e përkohshme për shitje apartamente banimi, datë 09.03.1995 (3 fletë). Mandatarkëtimi nr. ***, datë 09.03.1995 (1 fletë). Kontratë shitje me kusht, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.03.1999 (5 fletë). Librezë për kthim kredie, nr. *** (2 fletë). Mandatarkëtimi nr. ***, datë 05.06.2000(1 fletë). Deklaratë noteriale, nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 07.06.2000 (4 fletë).

¹⁷ Shih, shkresën nr. *** prot., datë 09.10.2018, të “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

- Me kontratën e përkohëshme për shitje apartament banimi, datë 09.03.1995, Enti Kombëtar i Banesave i ka shitur paraprakisht subjektit të rivlerësimit, apartamentin banimi, 2+1, ndodhur në, Rr. “****” (***), Tiranë. Me mandatarëtimin nr. ***, datë 09.03.1995, rezulton se subjekti ka shlyer shumën 90.000 lekë, shumë kjo e përcaktuar për t’u shlyer në kontratën e përkohëshme të datës 09.03.1995.

- Më datë 19.03.1999, është lidhur kontrate shitje me kusht, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.03.1999, midis subjektit dhe shitësit, Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Tiranë, për apartamentin, ndodhur në , Rr. “****”, në vlerën 1.304.550 lekë. Sipas kësaj kontrate, pas zbritjeve të bëra, përfshirë këtu edhe këstet e paguara nga subjekti prej vitit 1995, ai ka qenë i detyruar të shlyente shumën prej 1.034.737 lekë. Në kontratë është përcaktuar se Enti Kombëtar i Banesave do të mbajë pronësinë në emër e për llogari të tij, deri në shlyerjen përfundimtare të kësaj shume.

- Me mandatarëtimin nr. ***, datë 05.06.2000, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shlyer përfundimisht shumën 983.817 lekë për llogari të Entit Kombëtar të Banesave (pasi ka paguar këste të mëparshme mujore), gjë që konfirmohet me deklaratën noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.06.2000. Për shlyerjen e kësaj shume, është përdorur një pjesë e kredisë prej 2.500.000 lekësh e disbursuar, më datë 12.05.2000, nga Banka e Kursimeve në favor të subjektit. Ndërkohë, pjesa tjetër, është përdorur për përmirësim kushtesh të kësaj banese.

Lidhur me kredinë në vlerën prej 2.500.000 lekë, ka rezultuar se:

- Duke qenë se subjektit i takonte një kredi për përmirësim kushtesh/zgjerim, sipas VKM-së, nr. 102, datë 05.03.1999, atij i është dashur që përpara se të aplikonte për këtë kredi, të kishte në pronësi një pasuri të paluajtshme me qëllim bllokimin e saj, për efekt të marrjes së kredisë (ndërkohe apartamentin në, Rr. “****” nuk e kishte akoma të regjistruar në emrin e tij, pasi disponohej nga Enti Kombëtar i Banesave).

- Për këtë qëllim, ai ka blerë një pasuri të paluajtshme me kontratën e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2000, duke u bërë pronar mbi pasurinë nr. ***, nga shitësit me mbiemër K., (gjini e afërt e bashkëshortes së subjektit), në çmimin në vlerën prej 2.500.000 lekësh.

- Pasi ka aplikuar për kredi, me kontratën e huas nr. ***, datë 12.05.2000, subjektit i është dhënë huaja në shumën 2.500.000 lekë. Ndërkohë, me kontratën e hipotekimit, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.05.2000, pasuria nr. ***, ndodhur në, Rr. “****”, është vënë si garanci hipotekore deri në shlyerjen e huas.

- Me disbursimin e kredisë, më datë 12.05.2000, në datën 05.06.2000, është shlyer totalisht shuma e mbetur për blerjen e pasurisë, apartament banimi, ndodhur në, Rr. “****”, duke u paguar shuma prej 983 817 lekë, përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave.

- Pasi është regjistruar ky apartament si pasuri me nr. ***, ndodhur në, Rr. “****”, në emër të subjektit dhe bashkëshortes, e lirë nga çdo barrë hipotekore, sipas vërtetimit hipotekor, datë 10.01.2005¹⁸, me kontratë hipoteke, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.05.2001, kjo pasuri është vënë si garanci për shlyerjen e kredisë në vlerën prej 2.500.000 lekë, të marrë nga Banka e Kursimeve, ndërkohë që apartamenti i ndodhur në, Rr. “****”, vazhdonte të ishte i bllokuar në favor të kësaj banke.

- Me deklaratën noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.06.2001, Banka e Kursimeve, ka dhënë pëlqimin që pasuria, apartament banimi, ndodhur në, Rr. “****”, të lirohet nga barra hipotekore dhe të vazhdojë të mbetet e bllokuar vetëm pasuria, nr. ***, ndodhur në, Rr. “****”. Kjo pasuri, ka vijuar të mbetet e kufizuar në hipotekë për kredinë në vlerën prej 2.500.000 lekësh, e cila siç rezulton e vërtetuar me dokumente shpresore, është shlyer në vitin 2005.

- Pasi është liruar nga barra hipotekore, pasuria apartament banimi, ndodhur në, Rr. “****”, i ka kaluar përsëri ish- pronarëve, çiftit K., me kontratën, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.07.2001¹⁹.

Pra, rezultoi e vërtetuar se kontrata e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2000, për blerjen e pasurisë së ndodhur në, Rr. “****” (e lidhur jashtë periudhës së rivlerësimit), nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike për subjektin e rivlerësimit. Ajo është lidhur vetëm për shkak se subjektit i nevojitej vënia si garanci hipotekore e një pasurie të paluajtshme, me qëllim marrjen e kredisë në vlerën prej 2.500.000 lekësh (pasi apartamenti në, Rr. “****”, ka qenë i bllokuar për Entin Kombëtar të Banesave deri në shlyerjen përfundimtare të çmimit të blerjes nga subjekti).

Për sa më sipër, është vërtetuar plotësisht deklarimi i subjektit se, kredia në vlerën prej 2.500.000 lekësh, marrë nga Banka e Kursimeve, ka qenë burim krijimi për apartamentin e banimit, ndodhur në, Rr. “****”. Kjo kredi është përdorur pjesërisht për shlyerjen përfundimtare të çmimit të këtij apartamenti të përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave (*si i pastrehë, sipas VKM-së, nr. 605, datë 05.12.1994*), dhe pjesa tjetër për përmirësimin e kushteve të tij (*kredi për përmirësim kushtesh, sipas VKM-së, nr. 102, datë 05.03.1999*).

2.4.b. Kredi bankare.

Nga hetimi administrativ, rezultoi e vërtetuar se subjekti ka marrë dy kredi të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt shqyrtimi (*apartament banimi i blere nga shoqëria “****” sh.p.k*), si vijojnë:

- Me kredinë e marrë nga “NBG”, dega Tiranë, me kontratën, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.04.2004²⁰, në shumën 45.000 euro, për blerjen e një apartamenti me adresë: Rr. “****”,

¹⁸ Shih, dokumentet bashkangjitur në përgjigjet e pyetësorit të datës 29.10.2018 në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Shih, kontratën bashkëngjitur me përgjigjet e datës 17.10.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁰ Shih, dokumentin në dosjen e ILDKPKI-së.

Tiranë, me afat 17 vjet (*deklaruar nga subjekti e shlyer në deklarin periodik për vitin 2010, e vërtetuar kjo me dokumente bankare*²¹), është paguar kësti i parë i çmimit të blerjes së pasurisë. Me mandatpagesën, datë 19.05.2004,²² vërtetohet se shuma prej 45.000 eurosh, ka kaluar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

- Me kredinë e marrë nga “NBG”, me kontratën me nr. ***, datë 17.12.2005²³, për shumën 15.000 euro, me qëllim financimin e apartamentit, me adresë, në Tiranë, është paguar kësti i dytë i çmimit të blerjes. Me vërtetimin e lëshuar nga “ABI Bank”, më datë 02.11.2018²⁴, u vërtetua se, më datë 21.12.2015, shuma prej 14.750 eurosh, ka kaluar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

2.4.c. Kursime familjare, të cilat janë vërtetuar të jenë nga burime të ligjshme gjatë analizës financiare.

2.5. Lidhur me trajtimin e mundshëm preferencial të subjektit të rivlerësimit dhe konfliktit të mundshëm të interesit me palën shitëse dhe perfaqesuesat e saj, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë:

2.5.a. U kërkuan dhe u administruan 6 (gjashtë) kontrata sipërmarrje të lidhura midis shoqërisë “****” sh.p.k., dhe gjashtë shtetasve me cilësinë e porositësve²⁵, ku ka rezultuar se çmimi mesatar për m² është rreth 600 euro m², ndërkohë që çmimi për një m² për subjektin e rivlerësimit është në vlerën rreth 440 euro.

2.5.b. Lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë, i janë kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit i cili sqaroi se²⁶ “... një nga arsyet e rënies dakord me investitorin, z. A. A, për çmimin 60.000 euro, në kontratën e sipërmarrjes, ka qenë se kjo shumë do të likujdohej tërësisht brenda një viti, (ashtu siç ka ndodhur) dhe jo me këste sikurse ishte rënë dakord me blerës të tjerë. Më pas, është rënë dakord me administratorin e shoqërisë, z. P. Ç, për të paguar çmimin në vlerën prej 56.571 euro”. Në vijim subjekti me të drejtë pretendon se çmimi i shitjes, në fund të fundit ka qenë një marrëveshje e palëve dhe se ai nuk është çmim përfundimtar, për shkak se nuk është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes së pasurisë.

2.5.c U administrua kontrata e shtetasit B. L ²⁷, me të cilën rezulton se ky shtetas ka lidhur kontratë me shoqërinë “****” sh.p.k., për një apartament banimi një kat më sipër apartamentit të subjektit, me të njëjtën sipërfaqe prej 138.35 m² dhe me të njëjtën vlerë 56.571 euro.

²¹ Shih, shkresën nr. *** prot., datë 22.01.2018, të “NBG”-së në dosjen e Komisionit.

²² Shih, fletën nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

²³ Shih fletet nr. *** ne dosjen e ILDKPKI

²⁴ Shih, shkresën e “ABI Bank”, nr. *** prot., datë 2.11.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁵ Shih, kontratat në dosjen e Komisionit dhe procesverbalin datë 08.11.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shih, shpjegimet e dhëna në datë 7 dhjetor 2018, mbi rezultatet e hetimit, në dosjen e Komisionit.

²⁷ Shih, dokumentet bashkëngjitur shpjegimeve të dhëna, më datë 7 dhjetor 2018, mbi rezultatet e hetimit, në dosjen e Komisionit.

2.5.d. U administruan katër vërtetime të lëshuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Renda dhe Gjykata e Lartë,²⁸ nga të cilat rezultoi se subjekti nuk ka pasur çështje në shqyrtim, dhe në asnjë rast nuk rezultoi të jetë përfshirë në zgjidhjen e praktikave, ku pjesëmarrës në cilindo lloj status, kanë qenë shoqëria “****” sh.p.k., investitori në ndërtim A. A si dhe administratori i saj, z. P. Ç, gjë që përputhet me deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit, datë 29.10.2018.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni, çmon se nuk ka të dhëna që të vërtetojnë se subjekti i rivlerësimit është trajtuar me çmim preferencial për blerjen e apartamentit nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k., me të cilën, nuk rezultoi të ketë qënë në situatë konflikti i interesit (ashtu sikurse nuk rezultoi të ketë qënë në konflikt i interesit me përfaqësuesin e shoqërisë, z. P. Ç dhe investitorin në ndërtim, z. A. A).

3. Tokë Arë, në bashkëpronësi (16.6 %), në fshatin *, Durrës,** blerë sipas kontratës nr. *** rep., datë 07.12.2006, në vlerën e paguar 466.000 lekë, për pjesën takuese prej 933 m², ose 1/6 e sipërfaqes totale prej 5.600 m². Brenda çmimit të blerjes përfshihet edhe ndërtesa ish-vendroje ushtarake, me sip. 79.31 m², (e shkatërruar), pjesë takuese sipas marrëveshjes me bashkëpronarët. Në vitin 2007 është bërë pagesë punimesh për rrethim, kanalizim, ndarje, sistemim, etj në vlerë 1.500.000 lekë. Vlera totale e pasurisë është deklaruar në shumën prej 1.966.000 lekësh (pasuri e shitur pas deklaratës “Vetting” në gusht 2017).

Burimi i deklaruar i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat familjare ndër vite.

3.1. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

ZVRPP-ja Durrës nuk e ka konfirmuar këtë pasuri në emër të subjektit apo personave të lidhur²⁹, (pasi pasuria është tjetërsuar nga subjekti pas deklaratës “Vetting”) dhe ka vënë në dispozicion praktikën e origjinës së kësaj pasurie.

3.2. Kjo pasuri është deklaruar:

3.2.a. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2006, si 1/6 pjesë, paguar në shumën 466.000 lekë.

3.2.b. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2007 me përshkrim, “paguar punime në truallin e deklaruar vitin e kaluar (ndarje dhe sistemim i pjesës takuese, përgatitje për ndërtim banesë)”, në shumën prej 1.500.000 lekësh.

3.2.c. Në deklaratën “Vetting” si në pikën 3 më sipër, me burim krijimi të ardhurat familjare ndër vite.

Nuk ka pasaktësi në deklaratat periodike.

²⁸ Shih, shkresën nr. ***prot., datë 31.10.2018, bashkëngjitur me përgjigjet e pyetësorit të datës 29.10.2018.

²⁸ Shih, shkresën nr. ***prot., datë 01.11.2018, bashkëngjitur me përgjigjet e pyetësorit të datës 29.10.2018.

²⁸ Shih, shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme, nr. ***prot., datë 02.22.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Shih, shkresën e Gjykatës së Lartë, nr. ***prot., datë 31.10.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shih, shkresën nr. ***prot., datë 28.09.2017, të ZVRPP-së Durrës, në dosjen e ILDKPKI-së.

3.3. Lidhur me origjinën e pasurisë :

Nga aktet bashkangjitur shkresës së ZVRPP-së Durrës³⁰, rezulton se:

3.3.a. Pasuria toke “ARË”, nr. ***, në ***, Durrës, ka qenë në pronësi të, z. I. H. D, sipas certifikatës me datë lëshimi 27.10.2006. Për këtë pasuri është lëshuar kartela e pasurisë e cila në përshkrimin e veçantë është bosh (nuk figurojnë të pasqyruara tre objektet e përmendura në kontratën e shitjes së pasurisë).

3.3.b. Me kontratën e shitjes, nr. ***, datë 07.12.2006, pasuria e llojit tokë arë dhe tre objektet e ndodhura mbi të, kanë kaluar nga z. I. H. D (dhe anëtarë të familjes sipas certifikatës familjare të administruar), në emër të shtetasve J. A, K. H, Arben Kraja, P. K, L. S dhe D. K, në çmimin e shitjes 2.800.000 lekë në total (pjesa takuese e subjektit, në vlerën 466.000 lekë).

3.3.c. Me kontratën e shitjes, nr. ***, datë 09.08.2017³¹, pjesa takuese e subjektit (1/6) i është shitur shtetasit J. A njëri prej bashkëpronareve, në çmimin e shitjes 12.859 euro.

3.3.d. Duke qenë se ka pasur paqartësi lidhur me origjinën e tre objekteve të përmendura në kontratën e shitjes, por të papasqyruara në kartelën e pasurisë që ka shërbyer për kontratën e shitjes së pasurisë, nga ana e Komisionit janë kryer veprimet si vijojnë:

- I janë kërkuar sqarime subjektit i cili midis të tjerave sqaron se ³²: “ ..nuk kam asnjë dijeni se cila është origjina e krijimit të tyre. ... ”
- I janë kërkuar të dhëna, ZVRPP-së Durrës³³ e cila ka vënë në dispozicion dokumentet si vijojnë :

- Aktin e marrjes së tokës në pronësi në emër të shitësve, me nr. *** Akti, datë 25.09.1994.
- Certifikatën e pronësisë për pasurinë tokë arë, me sip. 5600 m², kartelën e pasurisë dhe dy certifikata të përbërjes familjare të shitësit.
- Tre kontrata shitjeje, më datë 15.08.1997, sipas të cilave shitësi I. D (shitësi), ka blerë nga dega e AKP-së Durrës, tri objekte, si dhe tri vërtetime të hipotekës për këto pasuri të regjistruara në regjistrin hipotekor përkatësisht me nr. ***, datë 09 shtator 1997, nr. ***, datë 09 shtator 1997 dhe nr. ***, datë 09 shtator 1997 (bashkangjitur planimetri për secilin objekt).
- Kontratën e shitjes nr. ***, datë 07.12.2006, midis shtetasve I. D, etj, me cilësinë e shitësve dhe subjektit të rivlerësimit, etj, me cilësinë e blerësve, të pasurisë truell në ***, Durrës. Në këtë kontratë (e cila nuk ka bashkangjitur asnjë dokument hipotekor lidhur me tri objektet³⁴),

³⁰ Shih, shkresën nr. ***prot., datë 28.09.2017, të ZVRPP-së Durrës, në dosjen e ILDKPKI-së.

³¹ Shih, shkresën nr. ***prot., datë 28.09.2017, të ZVRPP-së Durrës, në dosjen e ILDKPKI-së.

³² Shih, përgjigjet e datës 17.10.2018 të pyetësorit nr. 2, pika 3, në dosjen e Komisionit.

³³ Shih, shkresën nr. ***prot., datë 09.10.2018, si dhe shkresën nr. ***, datë 07.11.2018, të ZVRPP-së Durrës, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Shih, kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.12.2006, në dosjen e Komisionit dhe dokumentet bashkëgjitur, të vëna në dispozicion nga notere G. B, e cila disponon arkivën e noter B. T.

në rubrikën shënim i veçantë, janë përmendur të tri objektet e sipërpërmendura. Numrat e tyre në regjistrin hipotekoj sipas kontratës, përputhen me numrat e vëna në dispozicion nga ZVRPP-ja Durrës për të tri objektet të përmendura më sipër.

- Kartelën e pasurisë së paluajtshme që i përket pasurisë nr. ***së bashku me një skicë, në emër të subjektit dhe bashkëpronarëve.

- Kontratën nr. ***, datë 09.08.2017, për shitjen e pjesës takuese 1/6 të subjektit të rivlerësimit të blerësi J. A. Në kartelën e sipërpërmendur, pasqyrohet transkriptimi i 1/6 pjesë të subjektit, të blerësi J. A.

Bazuar në të gjitha dokumentet e administruara si më sipër, u sqarua çdo paqartësi lidhur me tri objektet e ndodhura mbi tokën “ARË” objekt shitjeje, pasi rezultoi e vërtetuar se shitësi i pasurisë, z. I. D, i ka përfituar në mënyrë të ligjshme të tri objektet e përmendura në kontratën e shitjes nr. ***, datë 07.12.2006, me tre kontratat e blerjes nga AKP-ja, dhe i ka pasur të regjistruara në regjistrat hipotekore.

3.4. Veç sa më sipër, për këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ janë kryer veprime verifikuese, si vijojnë:

3.4.a. I është kërkuar informacion ALUIZNI-t dega Tiranë, nëse ka pasur vetëdeklarime për legalizim objektiv të ndodhura në pasurinë me nr. ***. Ky institucion ka informuar se ³⁵ evidentohen si aplikantë për legalizim shtetasit, I. H. D, J. D. A dhe P. N. K. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë aplikuar për proces legalizimi.

3.4.b. Janë kërkuar të dhëna lidhur me regjistrimin e pasurisë nr. ***, tokë “ARË”, me sip. 5600 m², në ***, Durrës, në emër të I. H. D, dhe DAMT, Durrës ka konfirmuar se kjo sip. toke “ARË”, është përfituar nga ky shtetas sipas ligjit nr. 7501³⁶, duke vënë në dispozicion kopje të fletës 22 nga libri i formularit 6, ku ndodhet e regjistruar toka bujqësore me të cilën është trajtuar familja e z. I.D., të dhënat e të cilës përputhen me AMTP të lëshuar në emër të këtij shtetasi më 25.09.1994.

3.4.c. Janë kërkuar të dhëna lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shitësit e kësaj pasurie, përkatësisht shtetasit I. H. D, Sh. F. D dhe A. I. D.. Prokuroria e Përgjithshme³⁷ konfirmon se subjekti nuk ka pasur në shqyrtim çështje penale apo kallëzim penal që i përket këtyre shtetasve dhe se nga kontrolli i dokumentacionit arkivor nga viti 2002 deri në tetor 2018, nuk ka pasur praktika në shqyrtim ku janë përfshirë shtetasit e lartpërmendur. Pra, nuk rezulton që subjekti të jetë në situatë konflikti interesi me shitësat e pasurisë.

35 Shih, shkresën nr. ***prot., datë 12.10.2018. në dosjen e Komisionit.

36 Shih, shkresën nr. ***prot., datë 23.11.2018, në dosjen e Komisionit.

37 Shih, shkresën nr. ***prot., datë 14.11.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit të datës 12.11.2018, dërguar në datë 16.11.2018, në dosjen e Komisionit.

3.5. Lidhur me burimin e krijimit :

Gjatë analizës financiare, u vërtetua se subjekti ka pasur mjaftueshëm kursime familjare nga të ardhura të ligjshme, për blerjen e kësaj pasurie.

4. Autoveturë, tip “Benz”, prodhim i vitit 1997, me targë ***, blerë sipas kontratës nr. *** rep., datë 22.03.2007, në vlerë 250 000 lekë, plus 340.000 lekë paguar për zhdoganim, gjithsej 590.000 lekë, në pjesë takuese 100 %.

Burimi i deklaruar i krijimit të pasurisë: të ardhurat familjare ndër vite.

4.1. Gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se :

DPSHTRR³⁸ ka informuar se z. Arben I. Kraja, ka të regjistruar automjetin me targë ***. Ky mjet është blerë nga shtetasi N. F. Rr në shumën 250.000 lekë.³⁹

4.2 Kjo pasuri është deklaruar:

4.2.a. Në vitin 2007, ku është deklaruar se subjekti ka paguar zhdoganimin e mjetit, në shumën 340.000 lekë.

Për të vërtetuar këtë fakt, është pyetur subjekti i rivlerësimit i cili ka vërtetuar me dokumente shkresore⁴⁰ se zhdoganimi i mjetit realisht është paguar nga ai, fakt të cilin i cili e ka deklaruar që në momentin e parë (deklarimin për vitin 2007) e në vijim.

4.2.b. Në deklaratën “Vetting”, me përshkrimin si në pikën 4 më sipër.

Nuk kanë rezultuar pasaktësi dhe dyshime lidhur me këtë pasuri.

4.3. Lidhur me burimin e krijimit :

Gjatë analizës financiare, u vërtetua se subjekti ka pasur mjaftueshëm kursime familjare nga të ardhura të ligjshme, për blerjen e kësaj pasurie.

5. Blerje Obligacione të Qeverisë Shqiptare në “Raiffeisen Bank”, me afat 10 vjeçar, në ankandin nr. ***, datë 15.10.2015, në shumën 2.200.000 lekë, me Yield 8.8 %, datë emetimi 23.10.2015 dhe datë maturimi 23.10.2015. Frekuenca e kuponit 6 mujore. Zotërimi: 100 %. Burimi i deklaruar i krijimit mbyllja e depozitës “****” të vajzës në “Raiffeisen Bank” në vitin 2015 dhe kursime nga të ardhurat familjare ndër vite.

³⁸ Shih, shkresën nr. ***prot., datë 02.02.2018. të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

³⁹ Shih, kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2007, të noter I. H, bashkëngjitur shkresës nr. ***prot., datë 16.02.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴⁰ Shih, përgjigjet e pyetësorit të datës 29.10.2018 në dosjen e Komisionit dhe dokumentet bashkëngjitur: Kontratën e shitblerjes, datë 22.03.2007; urdhër çlirimi, datë 21.03.2007, lëshuar nga Dogana Shkodër; vërtetim zhdoganimi, datë 21.03.2007, lëshuar nga Dogana Shkodër, tre mandatarëkëtime, datë 21.03.2007, që konfirmojnë pagesën e detyrimeve doganore nga shtetasi N. Rr.

Nga analiza financiare, me shkresat numër ***prot, date 26.01.2018 dhe numër *** prot, datë 09.10.2018, të RF Bank, është verifikuar se më datë 15.10.2015, subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në ankandin për blerje Obligacione të Qeverisë Shqiptare në *Raiffeisen Bank*, me afat 10 vjeçar, me shumën 2 200 000 lekë, datë emetimi 23.10.2015 dhe datë maturimi 23.10.2015.

Burimi i të ardhurave të ligjshme është verifikuar gjatë analizës financiare, si vijon:

5.1 Me datë 14.10.2015, me konfirmim të departamentit ligjor, është vërtetuar se shuma prej 1,861,423.45 lekë, ka kaluar me transfertë nga llogaria bankare KID e cila ka qënë në emër të vajzës K. K, (gjendja e të cilës ndër vite pasqyrohet si në tabelën me poshtë) në llogari page të prindit Arben Kraja me nr. ***. Gjendja e kësaj llogarie bankare në këtë datë bëhet 2,500,000 lekë.

Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Depozite ne Raiffeisen Bank per vajzen K. K								(-1,861,423.45)
	45,000	172,895	297,373	487,923	756,132	1,175,942	1,591,424	0

5.2.Me datë 15.10.2015, zoti Arben Kraja e ka transferuar shumën 2.500.000 lekë në llogarinë bankare nr. *** për obligacione, dhe më date 23.10.2015 ka marrë pjesë në ankand.

5.3. Me datë 23.10.2015, është kredituar llogaria bankare (llog. page) me 300,000 lekë me pershkrim “ kthim fondesh prorata”

6. Llogari në “Raiffeisen Bank” në të cilën kalojnë kuponat (*interesi*) nga Obligacionet si më lartë. Gjendja, më datë 20.01.2017, në vlerën 3.60 lekë. Pjesë takuese: 100 %.

Ky likuiditet, dhe deklaratimet e subjektit janë vërtetuar gjatë hetimit administrativ, me shkresën e “Raiffeisen Bank”, nr. *** prot., date 26.01.2018

7. Llogari në fondin e investimit “Raiffeisen Prestigj” në “Raiffeisen Invest”, e çelur më 27.04.2016 dhe investuar shuma 382.000,00 lekë. Gjendja, më datë 20.01.2017, ka qënë 391.536,13 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i deklaruar i krijimit, të ardhurat familjare ndër vite.

Ky likuiditet dhe deklaratimet e subjektit janë vërtetuar gjatë hetimit administrativ, me shkresën e “Raiffeisen Bank”, nr. *** prot., datë 26.01.2018. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e tij.

8. Llogari e pagës mujore në “Credins Bank”. Gjendja, më datë 20.01.2017, ka qene (-) 8.790, 83 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Kjo llogari është, vërtetuar gjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. *** prot., datë 13.03.2018, nga “Credins Bank”.

9. Llogari në “Alpha Bank” Tiranë. Gjendja, më datë 20.01.2017, ka qenë 24.76 euro. Pjesa takuese: 100 %, vërtetuar gjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. *** prot., datë 12.02.2018, nga “Alpha Bank”,

10. Llogari në “Intesa Sanpaolo Bank” Tiranë. Gjendja, më datë 20.01.2017, ka qene 5. 61 USD. Pjesa takuese 100 %, vërtetuar gjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. ***prot., datë 02.02.2018, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

11. Llogari në Bankën Kombëtare Tregtare Tiranë. Gjendja, më datë 20.01.2017, ka qenë 451.31 euro. Pjesa takuese: 100 %, vërtetuar gjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. *** prot., datë 07.02.2018, nga Banka Kombëtare Tregtare.

PASURI TË DEKLARUARA NGA BASHKËSHORTJA

1. Apartamente banimi, me sipërfaqe 53.92 m² dhe 66.45 m², në adresën: Rr “****”, pall ****, ap. **, Tiranë, ndërtimi i vitit 1988, ku banojnë prindërit e bashkëshortes, përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore në vitin 1993. Pjesa e bashkëshortes ¼ e pasurisë, si pjesë e certifikatës familjare në kohën e privatizimit. Apartamentet janë vendosur si kolateral për kreditë e marra pranë “NBG”-së në vitin 2004, 2005 dhe pranë “BKT”-së në vitin 2010. Nuk është bërë rivlerësimi i pasurive.

1.1.Nga hetimi administrativ ka rezultuar se :

ZVRPP-ja Tiranë⁴¹ ka konfirmuar regjistrimin e pasurisë me nr. **, vol. **, fq. **, ZK ** dhe **, vol. **, fq. **, ZK **, në emër të bashkëpronarëve M., mes të cilëve është edhe personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit, G. K. Të dy pasuritë rezultojnë të kufizuara në hipotekë në favor të “BKT”-së.

1.2 Këto dy apartamente janë deklaruar :

1.2.a Në deklarin për vitin 2003, si dy apartamentet me nr. ** dhe nr. **, përfituar nga privatizimi në vitin 1994, në pjesë takuese: ¼.

1.2.b. Në deklaratën “Vetting” si në pikën 1 më sipër.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja⁴², dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit bazuar në dokumente shkresore⁴³ rezultoi e vërtetuar se apartamentet janë

41 Shih, shkresën nr. ***prot., datë 12.10.2018, të ZVRPP-së Tiranë në dosjen e Komisionit.

42 Shih, kontratën e shitjes së apartamentit të banimit me pagesë të menjëhershme, datë 25.10.1994, bashkëngjitur shkresës nr. ** prot., datë 12.10.2018, të ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

43 Shih, përgjigjet e pyetjeve të datës 12.11.2018, dërguar më datë 16.11.2018, dhe dokumentet bashkëngjitur: Kontrate shitblerje nga “EKB”, datë 26.10.1994; Autorizim i EKB, datë 28.10.1994; Certifikatë familjare të bashkëshortes së subjekti,

përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave (ish- Ndërmarrja Komunale Banesa), në vitin 1994, me kontrate shitje në emër të prindërve të bashkëshortes së subjektit, të motrës dhe në emër të saj.

Gjatë hetimit administrativ, rezultoi se këto dy pasuri, ku bashkëshortja e subjektit, është bashkëpronare “*de jure*” në ¼ pjesë me anëtarë të tjerë të familjes prindërore, janë përfituar (jashtë periudhës së rivlerësimit) në mënyrë të ligjshme prej tyre dhe janë deklaruar saktësisht që në deklarin e parë, deklarin për vitin 2003.

Lidhur me këto pasuri, u vërtetua se çmimi total i blerjes së tyre ka qenë përkatësisht në shumën 124.495 lekë dhe 101.019 lekë, dhe pagimi i çmimit të shitjes është bërë nga babai i bashkëshortes së subjektit, F. M, sipas mandatpagesave me nr. *** dhe ***, datë 26.10.1994.⁴⁴ Pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit për të dyja apartamentet është, në vlerën 56.378 lekë.

Duke marrë në konsideratë se pronësia mbi këto pasuri është fituar në vitin 1994, pra shumë herët, ato nuk janë përfshirë në analizën financiare. Por, nisur nga vlera e vogël e tyre, si dhe faktin që babai i bashkëshortes së subjektit, F. M, ka ushtruar aktivitet privat për shoqërinë “****”, me NUIS *** që në vitin 1994, (konfirmuar nga ILDKPKI-ja⁴⁵, fakt që u verifikua edhe në faqen *online* të QKB-së⁴⁶ nga ana e Komisionit), në perfundim të procesit të rivlerësimit, është çmuar se ka pasur burime të mjaftueshme financiare për blerjen e këtyre dy apartamenteve.

2. Automjet, tip “Volsvagen Golf 4”, prodhim i vitit 1998, me targë *, i blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.10.2015, në vlerë 2.000 euro. Pjesa takuese: 100 %. Nuk ka deklaruar burim krijimi.**

2.1 Nga hetimi administrativ rezultoi se:

DPSHTRR-ja konfirmon mjetin me targë ***, në emër të, G. K⁴⁷. Ky institucion ka vënë në dispozicion kontratën e shitblerjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.10.2015, të noter M. V, me çmim shitje në shumën 2.000 euro, shumë e likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

2.2. Kjo pasuri është deklaruar:

Në vitin 2015 me të njëjtin përshkrim si në deklaratën “Vetting”, por pa deklaruar burim krijimi. Kjo pasaktësi në deklarin, e cila nga ana e subjektit është pranuar si një pakujdesi gjatë plotësimit të formularit, nga ana e Komisionit çmohet si formale, dhe që nuk ka sjellë asnjë

prindërve dhe motrës së saj, si dhe mandatarkëtimi nr. *** dhe nr. ***, datë 26.10.1994, mbi kryerjen e pagesave të dy apartamenteve përkatësisht në shumën 124.495 lekë dhe 101.019 lekë, në dosjen e Komisionit.

44 Shih dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetjeve të datës 12.11.2018, dërguar më datë 16.11.2018, në dosjen e Komisionit.

45 Shih, informacionin e dhënë nga “APP”, me shkresën nr. ***prot., datë 09.2017, në dosjen e ILDKPKi-së.

46 Shih ekstraktin historik të shoqërisë “****”, në dosjen e Komisionit (16 fletë).

47 Shih, shkresën nr. *** prot., datë 02.02.2018, në dosjen e Komisionit.

pasojë, pasi nga analiza financiare rezultoi se blerja e autoveturës, justifikohet me të ardhura të ligjshme.

3. Llogari kursimi në “Intesa Sanpaolo Bank”. Gjendja, më datë 20.01.2017, ka qenë 356,97 lekë. Pjesa takuese: 100 %, e verifikuar me shkresën, nr. *** prot., datë 02.02.2018, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

4. Llogari rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank”. Gjendja, më datë 20.01.2017, ka qenë 5.24 lekë. Pjesa takuese: 100 %, e verifikuar me shkresën, nr. ***prot., datë 02.02.2018, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

5. Llogari e pagës mujore pranë “BKT”-së. Gjendja, më datë 20.01.2017, ka qenë (-) 18.881,62 lekë. Pjesa takuese: 100 %, e verifikuar me shkresën, nr. *** prot., datë 07.02.2018, nga “Banka Kombëtare Tregtare”.

DETYRIMET FINANCIARE :

1. Kredi pranë “BKT”-së, në shumën 50.000 euro, me interes 5.5 %, marre sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., më datë 23.02.2010, me afat 10 vjet, me këst 478 euro/muaj.

Kjo kredi është deklaruar :

- Në deklaratën për vitin 2010, si kredi e marrë dhe e përdorur për shlyerjen e kredisë në shumëbn prej 60.000 eurosh, nga Banka Kombëtare e Greqisë, (45.000 euro në vitin 2004 + 15.000 euro në vitin 2005), me qëllim blerje apartamenti.

- Në deklaratën “Vetting”, është deklaruar me po të njëjtat deklarime. Nuk ka pasaktësi në deklarime.

Nga analiza e deklarimeve të subjektit dhe dokumenteve shkresore, rezultoi se :

1.1.Me kontratën e kredisë bankare, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.02.2010, Banka Kombëtare Tregtare, Dega Qendrore, i ka akorduar kredi në shumën 50.937 euro kredimarrësve, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, për blerje apartamenti (937 euro shpenzime kredie) me qëllim shlyerjen e pjesës së mbetur të dy kredive të mëparshme nga “NBG”.⁴⁸

1.2.Sipas Aneksit të elementëve specifikë të kredisë rezulton se kredia do të përdoret për likuidimin e dy kredive të marra pranë “NBG”-së dhe se shuma e disbursuar do të transferohet direkt në llogarinë e kredisë së subjektit të rivlerësimit në “NBG” me transfertë bankare nga “BKT”. Kreditë e marra nga “NBG” janë: Kredia në shumën prej 45.000 eurosh sipas kontratës

⁴⁸ shih, aneksin e elementëve specifikë të kredisë së dhënë, bashkangjitur kontratës së kredisë bankare, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.02.2010, në dosjen e ILDKPKI-së, faqe ***.

së kredisë, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.04.2004⁴⁹, dhe kredia në shumën 15.000 euro e marrë me kontratën me nr. ***⁵⁰ nga “NBG”. Disbursimi i kredive sipas kontratave, u vërtetua gjatë hetimit administrativ.

- Me kontratën e hipotekimit, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.02.2010, janë pasqyruar si kolateral për lëvrimin e kredisë të njëjtat prona të hipotekuara për llogari të “NBG”-së, për kredinë e marrë në shumën 45.000 euro, sipas kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.04.2004. Konkretisht, pasuritë apartament me sip. 53.92 m², pasuria nr. *** dhe apartament, me sip. 66.45 m², pasuria nr. ***⁵¹.

- Në kontratë është pasqyruar edhe fakti se banka është në dijeni që pronat e përshkruara si me lart, janë të hipotekuara në radhë të parë në favor të “NBG”-së për kreditë e marra pranë saj, dhe se është dakord që këto prona të hipotekohen në radhë të dytë në favor të “BKT”.

Në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se deklaratimet e subjektit lidhur me këtë detyrim, përputhen plotësisht me dokumentet e administruara.

2. Kartë Krediti “Master Card”, e dhënë nga “BKT”, me limit në shumën 200.000 lekë. Detyrimi për blerje të kryera deri, më datë 20.01.2017, në shumën 100.464,79 lekë, e deklaruar nga subjekti, dhe e vërtetuar gjatë hetimit administrativ me shkresën nr. *** prot., datë 07.02.201, të Bankës Kombëtare Tregtare.

3. Kartë krediti nga “BKT”, me limit në shumën 100.000 lekë. Detyrimi për blerje të kryera me kartën “BKT Prima”, më datë 20.01.2017, është në shumën 42.384,43 lekë, dhe e vërtetuar kjo gjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. *** prot., datë 07.02.2018, të Bankës Kombëtare Tregtare

Lidhur me kreditë:

Gjate hetimit administrativ, u konstatua se subjekti ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike, kreditë e marra ndër vite, ndërsa në deklaratën “Vetting” në rubrikën, TË DHËNA KONFIDENCIALE, ka renditur kreditë dhe bazën ligjore të dhënies së tyre. Nga ana e Komisionit, pasi u bë verifikimi i kredive me dokumente ligjore të marra në rrugë institucionale, u konstatua se ato janë përfituar nga subjekti i rivlerësimit në mënyrë të ligjshme. Gjithashtu, gjatë analizës financiare, u verifikua fakti që shlyerja e kredive është bërë sipas parashikimeve në kontratat përkatëse, me të ardhura të ligjshme të justifikuara plotësisht.

⁴⁹ Shih, dokumentin në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁰ Shih, fletët nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵¹ Shih, kartelat e pasurisë bashkëngjitur shkresës nr. ***prot., datë 12.10.2018, të ZVRPP-së Tiranë në dosjen e Komisionit.

Kerkime te tjera:

1. Duke qenë se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁵² ka informuar se shtetasi Arben Kraja ka rezultuar i regjistruar me NIPT ***, i janë kërkuar të dhëna Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe ky institucion informoi,⁵³ se sipas kërimit në sistemin *C@ts*, rezulton se, z. Arben I. Kraja, nuk ka në emër të tij leje ushtrimi profesional privat në këtë drejtori. Tatimpaguesi Arben Kraja, me NIPT ***, i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, më datë 16.10.2002, quhet A. B. K, pra nuk është subjekti i rivlerësimit.

2. Sipas informacionit nga RNSH, pranë Ministrisë së Drejtësisë,⁵⁴ nuk janë konfirmuar veprime noteriale të tjera të kryera nga subjekti Arben I. Kraja, përveç atyre të deklaruara.

ANALIZË FINANCIARE

Gjate hetimit administrativ, është bërë një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare, të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore. Nga analiza financiare për periudhën e rivlerësimit 2003 -2016, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, nuk rezulton që subjekti të ketë pasur deklarime të pasakta dhe nuk rezulton që të ketë pasur likuiditete të pajustificuara.

Viti	Të ardhura	Pasuritë	Detyrime	Shpenzime	Diferenca
2003	2,686,095	500,000	-207,300	473,684	1,712,411
2004	2,933,487	7,092,319	5,388,685	903,401	326,452
2005	5,603,125	1,162,228	98,236	2,174,023	2,365,109
2006	3,733,562	1,264,940	-241,565	1,757,966	469,092
2007	3,827,079	451,655	-252,018	2,302,583	820,824
2008	3,040,307	773,377	300,508	1,655,090	912,348
2009	3,450,303	-531,379	-656,230	1,018,860	2,306,593
2010	3,854,246	167,637	309,162	1,857,158	2,138,613
2011	3,933,619	417,135	-602,403	1,313,270	1,600,810
2012	3,360,604	874,115	-580,214	1,739,903	166,371
2013	3,373,478	155,986	-491,463	1,743,050	982,979
2014	3,100,949	756,230	-403,064	1,731,372	210,282
2015	2,968,970	987,516	-648,449	1,067,905	265,100
2016	3,320,092	-1,155,447	-301,093	1,907,896	2,266,551
TOTALI	49,185,917	12,916,313	1,712,793	21,646,162	16,336,235

52 Shih, shkresën nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 28.07.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

53 Shih, shkresën nr. *** prot., datë 10.10.2018, të DRT-së Shkodër, në dosjen e Komisionit.

54 Shih, shkresën nr. *** prot., datë 06.11.2018, të Ministrisë së Drejtësisë në dosjen e Komisionit.

Metodologjia e e perdorur gjate analizës financiare:

Gjatë kësaj analize, Komisioni, është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara dhe të vëna ne dispozicion nga : “Raiffeisen Bank”⁵⁵, “NBG”⁵⁶, Banka Kombëtare Tregtare⁵⁷, “Intesa Sanpaolo Bank”⁵⁸, “Credins Bank”⁵⁹, “Raiffeisen Bank”⁶⁰, “Raiffeisen Bank”⁶¹, “Veneto Bank”⁶², “Alpha Bank”⁶³, “Banca Popolare di Sondrio”, Milano.

b. Të ardhurat e ligjshme :

Në këtë kategori janë përfshirë të gjitha të hyrat nga pagat, interesat bankare si dhe të ardhura të tjera sipas rastit të subjektit dhe personave të lidhur. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti dhe personat e lidhur, janë vërtetuar me dokumente te vena ne dispozicion nga institucionet kompetente ligjore ku ata kanë qenë të punësuar, si vijojnë :

Vërtetime nga Prokuroria e Përgjithshme⁶⁴, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror⁶⁵, Prokuroria e Përgjithshme⁶⁶, Prokuroria e Përgjithshme⁶⁷, Kryeministria ⁶⁸, Shkolla e Magjistraturës⁶⁹, Universiteti Kristal⁷⁰, Universiteti Amerikan i Tiranës⁷¹, “Veneto Bank”⁷², ILDKPKI-ja⁷³, Banka e Shqipërisë⁷⁴.

c. Shpenzimet:

Në këtë kategori janë llogaritur të gjitha shpenzimet e deklaruara nga subjekti dhe personat e lidhur si: - shpenzime jetese bazuar në të dhënat e marra nga ILDKPKI-ja (shumën e llogaritur nga ILDKPKI-ja për gjithë periudhën e përpjesëtojmë me vitet që ka pasur detyrim për deklarim, duke marrë në konsideratë përbërjen familjare, për të nxjerrë mesataren e shpenzuar në një vit),

⁵⁵ Nr. *** prot., datë 26.01.2018, Banka Raiffeisen sha.

⁵⁶ Nr. *** prot., datë 22.01.2018, NBG.

⁵⁷ Nr. ***prot., datë 07.02.2018, Banka Kombëtare Tregtare.

⁵⁸ Nr. *** prot., datë 02.02.2018, Banka Intesa Sanpaolo sha

⁵⁹ Nr. *** prot., 13.03.2018, Banka Credins.

⁶⁰ Nr. ***prot, datë 09.10.2018, Banka Raiffeisen.

⁶¹ Nr. ***prot., datë 09.10.2018, Banka Raiffeisen.

⁶² Nr. *** prot., datë 25.01.2018, Banka Veneto.

⁶³ Nr. *** prot., datë 12.02.2018, Banka Alpha.

⁶⁴ Nr. *** prot., datë 20.10.2016, nga Prokuroria e Përgjithshme.

⁶⁵ Nr. *** prot., datë 24.10.2016; Arkiva Qendrore e Sigurimeve.

⁶⁶ Nr. *** prot., datë 09.01.2017, Prokuroria e Përgjithshme.

⁶⁷ Nr. *** prot., datë 20.10.2016, Prokuroria e Përgjithshme.

⁶⁸ Nr. *** prot., datë 13.10.2016, Kryeministria.

⁶⁹ Nr. *** prot., datë 18.10.2016, Shkolla e Magjistraturës.

⁷⁰ Datë 20.10.2016, Universiteti Kristal.

⁷¹ Datë 21.10.2016, Universiteti Amerikan i Tiranës.

⁷² Nr. ***prot. datë 21.10.2016, Vento Banka

⁷³ Nr. *** prot., datë 20.10.2016.

⁷⁴ Datë 18.01.2017, Banka e Shqipërisë.

- shpenzime shkollimi,
- shpenzime për pushime,
- shpenzime për arredimin e apartamentit të banimit,
- Shpenzime udhëtimi. Udhëtimet jashtë shtetit janë marrë të dhëna nga TIMS dhe për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit kanë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore duke filluar nga 180 euro për udhëtim për linjat low cost, deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi. Në rastet kur qëndrimi është deklaruar tek familjaret e subjektit dhe bashkëshortes së tij, janë llogaritur shpenzimin e udhëtimit si më lart si dhe kosto qëndrimi 20 euro/ditë).
- Si dhe çdo shpenzim tjetër të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive⁷⁵.

Rezultatet e rivlerësimit të pasurisë:

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, referuar nenit 33 të ligjit nr. 84/2006, për subjektin e rivlerësimit, zotin Arben Kraja, rezultoi se :

- Nuk ka pasur deklarime që vijnë në kundërshtim me ligjin (germa “a”, pika 5, e nenit 33).
- Ka pasur burime të ligjshme për justifikimin e pasurive (germa “b”, pika 5, e nenit 33).
- Nuk ka kryer fshehje pasurie (germa “c”, pika 5, e nenit 33).
- Nuk ka pasur deklarim të rremë (germa “c”, pika 5, e nenit 33).
- Subjekti nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit (germa “a”, pika 5, e nenit 33).

II. 2 . VLERËSIMI I FIGURËS

2.1 Me shkresën nr. ***, datë 31.10.2017, deklasifikuar me vendim të KDZH-së, nr. *** datë 28.03.2018, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pasi përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Kraja, sipas informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit, ka konkluduar se:

- Formulari i deklaramit është i plotë i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Grupi i punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

Gjatë hetimit administrativ, pas verifikimeve, është konstatuar plotësimi me saktësi i formularit për kontrollin e figurës nga ana e subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë, nuk ka pasur të dhëna,

⁷⁵ Shih, kontratën e sipërmartjes së apartamentit të banimit nga shoqëria “****”, datë 09.04.2004, kontratën e shitblerjes së tokës “ARË”, kontratës nr. *** rep., nr. ***kol., datë 07.12.2006, kontrate shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2007, si dhe kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.10.2015.

informacione dhe dyshime për kontakte te papërshtatshme me persona te perfshirë në krimin e organizuar, apo veprimtari korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Rezultatet e rivlerësimit të figurës :

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës.

II. 3 .VLERËSIMI PROFESIONAL

Sipas nenit 44 te ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit te rivlerësimit, bazuar në:

1. Raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Grupi i Punës i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 11.04.2018.
2. Vlerësimin e informacionit të marrë në rrugë zyrtare.
3. Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga grupi i punës në prokurorinë e përgjithshme është bazuar në:

1. Formularin e vetëdeklarimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, tre dokumente ligjore të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit:
2. Pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor si dhe
3. Të dhënat nga 23 Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, Zyrës së Informacionit të Klasifikuar, Sektorit të Protokoll-Arkivit si dhe burimeve arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në përfundim të analizës, Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka konstatuar:

1.1. Në lidhje me aftësitë profesionale :

a. Njohuritë ligjore

Nga vlerësimet e punës, rezulton se subjekti ka treguar aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota. Nga gjetjet në tre dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe në pesë dosjet e përzgjedhura në short, është identifikuar niveli i mire i njohurive ligjore. Njohuri ligjore te mira jane konstatuar edhe në analizat që bën subjekti në drejtim të kuptimit të

dispozitave penale dhe në trajtimin qartësisht të lëndës, duke dhënë rekomandime të vlefshme për punën e prokurorëve të shkallëve më të ulëta.

b. Arsyetimi ligjor

Subjekti ka treguar aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë arsyetim dhe shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që vendimmarrjet e tij të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt, dhe bazës ligjore të përdorur përgjatë arsytimit.

1.2. Në lidhje me aftësitë organizative:

Subjekti është dalluar për planifikim të mirë të punës, detyrave, si dhe për të kryer kontrollin e çështjeve. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në short, rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

1.3. Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale :

Subjekti ka marrë pjesë në aktivitetet profesionale, si për ngritjen e nivelit profesional, ashtu edhe në shkëmbimin e eksperiencave apo përfaqësimin e institucionit, brenda dhe jashtë vendit. Komunikimi, bashkëpunimi, sjellja ndaj eprore, kolegëve, vartësve dhe administratën ka qenë korrekte, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

Në periudhën 2005 - 2016 dhe aktualisht, është aktivizuar si ekspert i jashtëm i Shkollës së Magjistraturës për “Programin e Trajnimit Vazhdues”, për prokurorë dhe gjyqtarë. Për çdo vit kalendarik ka marrë pjesë si ekspert trajnues në disa trajnime të organizuara me prokurorë e gjyqtarë të shkallës së parë dhe apelit.

1.4. Në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimin profesional :

Subjekti ka përmbushur me korrektësi disiplinën formale lidhur me orarin, paraqitjen zyrtare, etikën, përmbushjen e angazhimeve për të ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Duke vlerësuar dosjen personale të subjektit, rezulton se ai është angazhuar jo vetëm në zgjidhjen e detyrave që i janë ngarkuar si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, por është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme dhe në aktivitete të tjera, për shkëmbimin e eksperiencave apo përfaqësimin e institucionit të prokurorisë brenda dhe jashtë vendit, në cilësinë e përfaqësuesit të institucionit të prokurorisë në Komitetin Këshillimor Ndërinstitucional “Për Masat Kundër Krimin të Organizuar”, si lektor i trajnimit vazhdues për prokurorë dhe gjyqtarë në Shkollën e Magjistraturës, si Anëtar i delegacionit shqiptar në Komitetin Moneyval të Këshillit të Evropës, Strasbourg, etj.

2. Informacioni i marrë në rrugë zyrtare:

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit nuk janë paraqitur denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja, sipas parashikimit ligjor të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nuk ka pasur informacione të njohura publikisht, në lidhje me aftësitë profesionale, etiken, aftësitë personale dhe angazhimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Pasi janë analizuar 5 dosjet e përzgjedhura me short dhe tre vendimet e përzgjedhura nga subjekti, nga ana e Komisionit, u arrit në të njëjtat konstatime si ato të Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Gjatë procesit të rivlerësimit, është bërë një analizë e hollësishme e praktikës, nr. *** prot., datë 07.05.2015, të Prokurorisë së Përgjithshme, zgjidhur me memon e konceptuar nga subjekti i rivlerësimit, më datë 14.05.2015.

Në këtë Memo, subjekti i rivlerësimit pasi ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasës D. B., kundër një vendimi të marrë nga Prokuroria e Shkalles së Parë Sarandë, për mosfillimin të një çështjeje penale, nuk i ka marrë në konsideratë pretendimet e saj. Ndërkohë, është konstatuar se në katër praktikat e tjera të shqyrtuara nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, subjekti i ka marrë në konsideratë kërkesat ankimore.

Pas shqyrtimit, Komisioni, vuri në dukje disa konstatime të cilat iu njoftuan subjektit të rivlerësimit, së bashku me rezultatet paraprake të hetimit. Konkretisht, nga ana e Komisionit është vlerësuar që subjekti (i) duhet të kishte më shumë në konsideratë faktet dhe rrethanat mbi të cilat është dhënë vendimi i mosfillimit të çështjes penale, duke bërë një analizë më të hollësishme të tyre, (ii) me qëllim një vlerësim sa më të drejtë të çështjes penale për shqyrtimin e ekspertimit të rreme, ajo nuk duhej kushtëzuar me vazhdimin e procesit civil, si dhe faktin që (iii) subjekti mund të administronte dosjen civile, ose vendimin e ndërmjetëm të gjykatës si dhe procesverbalin e dosjes gjyqësore për caktimin e ekspertit.

Lidhur me këto konstatime, subjekti ka parashtruar arsyetimet e tij⁷⁶ duke sqaruar se:

Memo-ja e konceptuar prej tij, bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat mbi të cilat është marrë vendimi i mosfillimit të çështjes penale, është shqyrtim ankimi dhe jo çështje e hetuar prej tij.

Gjithashtu, ai arsyeton se, Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon që në këtë proces vlerësimi, prokurori duhet të marrë akte të tjera jashtë akteve që ka kallëzimi. Lidhur me kushtëzimin e çështjes penale me zgjidhjen e çështjes civile, subjekti përveçse i referohet nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 273 - 277 të tij, përgjigjen e tij e lidh me praktiken e punës së Prokurorisë së Përgjithshme në rastet e shumta të ankesave të shtetasve,

⁷⁶ Shih, parashtrimet për rezultatet paraprake të hetimit të datës 07.12.2018.

kundër regjistrimit të procedimeve penale nga prokuroritë e rretheve gjyqësore për konflikte që ishin duke u zgjidhur nga gjykatat civile.

Ndërkohë, subjekti kujton se me shkresën nr. *** prot., datë 15.05.2015, të Prokurorisë së Përgjithshme, ku janë parashtruar arsyet e mospranimit të ankimit të shtetases D. B, kësaj shtetaseje, i është bërë e ditur e drejta për t'iu drejtuar me ankim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ankesë e cila nuk rezulton të jetë bërë prej saj, sipas dokumentacionit që Komisioni disponon.

Në përfundim, pavarësisht se subjekti rivlerësimi ka tejkalar përgjigjen e tij, duke iu referuar praktikës së ndjekur nga Prokuroria e Përgjithshme në rastet e regjistrimeve të procedimeve penale kundër akteve të ekspertimeve në gjykimet civile, Komisioni çmoi se sqarimet e tij lidhur me ligjshmërinë e memos janë bindëse, dhe krijoi bindjen se gjatë përpilimit dhe arsyetimit të kësaj memoje, ai ka vepruar në përputhje me ligjin, duke ushtruar të drejtat e tij si përfaqësues i organit me të lartë të akuzës bazuar në nenin 24/5 të Kodit të Procedurës Penale.

Rivlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit:

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr.9 6/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezultoi se :

- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit 96/2016.
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit 96/2016.
- subjekti i rivlerësimit ka një nivel të lartë të etikës dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit 96/2016.
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit 96/2016.

Ne përfundim, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit 84/2016.

Subjekti ka qënë i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar, gje që është mbajtur në konsideratë në marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

III. SEANCA DËGJIMORE

Më datën 13.12.2018 u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja, gjatë së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues i Komisionit, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, vlerësoi se procesi i vendimmarrjes në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Kraja, duhet të bazohet në vlerësimin tërësor të tri kriterëve, referuar nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të seancës dëgjimore, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Kraja, dhe shpall këtë vendim sot, në datën 17.12.2018, sipas nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 84/2016.

IV. KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

1. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni D), ligjit nr. 84/2016 (kreu IV), lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Kraja ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. (neni 59/a i ligjit);
2. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni DH), ligjit nr. 84/2016 (kreu V), lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Kraja ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës. (neni 59/b i ligjit);
3. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. (neni 59/c i ligjit).

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, bazuar në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit zotit Arben Kraja, me detyrë Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithëshme.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 17.12.2018.

ANTËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES
Roland ILIA

ANËTAR/RELATOR
Firdes SHULI

ANËTAR
Etleda ÇIFTJA

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj